



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE

Numri i Ceshtjes :	53801-00849-61-2018	Data e Regjistrimit :	10/04/2018
Numri i Vendimit:	61-2018-4753	Data e Vendimit :	25/09/2018

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Skender Haluci

SEKRETARE: Eglantina Murati

Sot më datë 25/09/2018 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Të pandehurit: X, i biri i xxxx, i datëlindjes xxx

Akuzuar: Gjykimi procedimit penal xxx ne ngarkim te te pandehurit X akuzuar per veprat penale te parashikuara nga neni 287/, 186/2 dhe 287/3 te KPenal

X Y

VEREN :

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
VLORE

Nr. 338(53801-00849-61-2018) Akti

Dt. Regj 10.04.2018

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e përbërë nga:

GJYQTAR: SKËNDER HALUCI

GJYQTARE: VJOLA CANAJ

GJYQTAR: ERVIN TRASHI

Me sekretare gjyqësore **Znj. Eglantina Murati**, në seancën gjyqësore të **date 25.09.2018** i dha fund gjykimit të çështjes penale **Nr.xxxx Akti** që u përket:

KËRKUES: **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë**, përfaqësuar në gjykim nga prokurori i seancës xxxxx. **I**

PANDEHUR: **X**, i biri xxx, i datëlindjes xxxx, lindur dhe banues në Vuno, Vlorë, me shtetësi shqiptare, me gjendje familjare i martuar, i pa dënuar më parë, i hetuar në gjendje të lirë, për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” të kryer më shumë se një herë përmes përdorimit të dokumentit të falsifikuar dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, që ka sjellë pasoja të rënda, e kryer në format e parashikuara nga gërmat “a” dhe “b” të paragrafit të parë të nenit 287 të Kodit Penal, parashikuar si vepra penale nga nenet 186/2 dhe 287/3 të Kodit Penal, i mbrojtur nga avokat Av. xxxx, anëtarë i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me adresë rruga “x”, pallati x, Tiranë.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i dokumenteve” të kryer më shumë se një herë përmes përdorimit të dokumentit të falsifikuar dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, që ka sjellë pasoja të rënda, e kryer në format e parashikuara nga gërmat “a” dhe “b” të paragrafit të parë të nenit 287 të Kodit Penal, parashikuar si vepra penale nga nenet 186/2 dhe 287/3 të Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 112, 379 dhe 384 i K.Pr.Penale dhe neni 186/2 dhe 287/3 i Kodit Penal.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata, pasi administroi provat e ndodhura në fashikullin e procedimit penal Nr.967 të vitit 2017 dhe pasi dëgjoi konkluzionet përfundimtare të palëve,ku:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlore, përfaqësuar nga Prokurori xxxxxx, kerkoi:

Deklarimin fajtor të te pandehurit X për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve” me shume se nje here permes përdorimit të dokumenteve të falsifikuara, parashikuar si vepra penale nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe denimin e tij me 4(kater) vite burgim.

Deklarimin fajtor të te pandehurit X për veprën penale të parashikuar nga neni 287/dh i Kodit Penal dhe denimin e tij me 18(tetembedhjete) vite burgim.

Ne aplikim të nenit 55 të kodit penal në bashkim të denimeve, denimin përfundimtar të te pandehurit X me 20(njezet) vite burgim.

Ne aplikim të nenit 190 dhe 391 të Kodit të Procedurës Penale të deklarohet falsiteti i dokumenteve që janë bashkuar në fashikullin e gjykimit dhe të disponohet në lidhje me to,dhe konkretisht në lidhje me keto dokumente:

Vërtetim date xxx leshuar leshur nga kryeplaku i fshatit xxxxx sekuestruar në dosjen gjyqësore që i perket vendimit civil nr. xxxxx.

Vërtetim i Komisionit të verifikimit të pronave pranë Bashkisë Himare date xxx,sekuestruar në dosjen gjyqësore që i perket vendimit civil nr. xxxx Gjykates së Rrethit Gjyqësor Vlore.

Procesverbal i mbajtur nga pleqësia e fshatit Vuno me date 21.11.2002 sekuestruar në dosjen gjyqësore që i perket vendimit civil xxx të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Vlore.

Vendimi nr. xxxx të Keshillit të Bashkisë Himare sekuestruar në dosjen gjyqësore që i perket vendimit nr. xxxx të Gjykates së Rrethit Gjyqësor bashkë me aktet e kesaj dosje gjyqësore si dhe vendimin gjyqësor, të deklarohen të falsifikuara dhe të asgjësohen.

Ne baze të nenit 36/b të K.Penal të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit dhe të fshihen nga regjistri i ZVRPP Vlore, produktet e vepres penale të “Falsifikimit të dokumenteve” të cilat janë nën masën e sigurimit të sekuestros preventive me vendimin nr. xxxxx të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Vlore, e konkretisht të:

Pasuria toke kullote me sipërfaqe 4.8 ha, ekonomia kullosore xxxxxxVxxxx e ndodhur në vendin e quajtur “xxx” ngastra 25, me kufij perkates, pasuri e regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme të ZVRPP në regjistrin hipotekor xxxx në favor të shtetasit xxx, nr. xxx në favor të X,pasuri e cila është ndare në dy pasuri të

tjera, konkretisht nr. xxxx në favor të shtetasit X dhe në vijim në regjistrin hipotekor nr. xxxx në favor të shtetasit xxx, ndersa pasuria me sipërfaqe 15.000 m e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. xxx hipotekor nr. 360 date 28.08.2012 në favor të xx

Shpenzimet proceduriale të kryera gjatë hetimit paraprak në shumën prej 100.000 leke si dhe ato të kryera gjatë gjykimit të ngarkohen të pandehurit X

Mbrojtësi i te pandehurit X, avokati xxxxxx, kerkoi:

- *Deklarimin e pafajshem të X për të gjitha veprat penale*

VËREN SE:

I. Procedura:

1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka sjellë për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë çështjen penale në ngarkim të pandehurit X i akuzuar për kryerjen e veprave penale "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer më shumë se një herë, përmes përdorimit të dokumentit të falsifikuar dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga nenet 186/2 dhe 287/3 të Kodit Penal.
2. Fillimisht gjykata mori në shqyrtim juridiksionin dhe kompetencën për gjykimin e kësaj çështje penale. Bazuar në nenet 69/1, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale shqyrtimi i kësaj çështje penale, hyn në juridiksionin gjyqësor dhe kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e saj është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kështu, sipas nenit 74 të K.Pr.Penale: "Gjykata e Rrethit Gjyqësor është kompetente për gjykimin e veprave penale, përveç atyre që i përkasin kompetencës së gjykatës për krime të rënda, gjykatës ushtarake dhe Gjykatës së Lartë." Sipas kësaj dispozite, vepra penale, objekt gjykimi, nuk është në kompetencën lëndore as të Gjykatës së Krimeve të Rënda, as të Gjykatës Ushtarake dhe as të Gjykatës së Lartë. Si rrjedhojë, kjo Gjykatë konstaton se ka kompetencë lëndore për shqyrtimin e çështjes penale objekt gjykimi. Ndërsa në lidhje me kompetencën tokësore, i referohemi nenit 76 të K.Pr.Penale që parashikon: "Kompetenca tokësore përcaktohet, me radhë, nga vendi ku është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja". Në rastin konkret konstatohet se veprat penale për të cilat akuzohet i pandehuri ka ndodhur në Vlorë. Në këto kushte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë është kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje penale.
3. Bazuar në nenin 13/3 të K.Pr.Penale që parashikon: "Gjykatat e rretheve gjyqësore gjykojnë me një gjyqtar veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 10 vjet. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë" gjykimi i kësaj çështje penale u zhvillua me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

II. Rrethanat e faktit:

4. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje penale u provua se, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka regjistruar procedimin penal nrxxxx, për veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuara nga nenet 186 dhe 287 të K.Penal. Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e vendimit të ndarjes së çështjes, të marrë në kuadër të procedimit penal nr.xxx. Objekt i hetimit të këtij procedimi penal kanë qenë dokumentet e pronësisë në lidhje me subjektin e shpronësuar xxxx. Nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera dhe provave të administruara në lidhje me këtë procedim penal ka rezultuar se: Me vendimin nr. xxxx, KVKKP-së Qarku Vlorë ka vendosur: "1-Të njohë të drejtën e pronësisë, subjektit të shpronësuar xxxx (trashëgimtarit të tij sipas dëshmisë së trashëgimisë me vendimin nr. xxx) për sipërfaqen 4.8 hektar (katër pikë tete) të ndodhur në ekonominë bujqësore "xxx në ngastrën nr. 25 në zonën kadastrale 3844 Vuno Himarë në vendin e quajtur "xxxxe" në fshatin xxx me kufij: V-Rruga, J-Deti, L-xxx dhe P-Musha Fshati, sipas nenit 6 pika 1 e ligjit 92235 datë 29.07.2004. 2. Të kthejë në natyrë trashëgimtarëve të xxx (trashëgimtarit të tij sipas dëshmisë së trashëgimisë me vendimin nr. xxx) për sipërfaqen kullotë 4.8 hektar (katër pike tetë) të ndodhur në ekonominë kullosore xxx" në ngastrën nr.xxx në zonën kadastrale 3844 xxxx në vendin e quajtur "Ngale" në fshatin xxxx Himarë me kufij: V-Rruga, J-Deti, Lxxxx dhe P-Musha fshati sipas nenit 6 pika 1 e ligjit 9235 datë 29.07.2004". Rezulton se i pandehuri X ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin përkatës pranë KVKK Pronave Qarku Vlorë.

Rezulton se prona e kthyer përmes këtij vendimi është regjistruar pranë ZVRPP Vlorë, në regjistrin hipotekor nr.190, datë 04.05.2007 me përshkrimin "xxxx, një tokë kullotë me sipërfaqe 4.8 ha (katër pikë tetë) e ndodhur në ekonominë kullosore Dhërmi-Vuno, në vendin e quajtur "xxxxx", në ngastrën 25 me këto kufizime V-Rruga, L-xxxx, J-Deti dhe P-Musha fshati", pronë e cila është regjistruar në emër të shtetasit xxxxx. Prona e mësipërme është regjistruar mbi bazën e aplikimit të pandehurit X, të paraqitur më datë 18.01.2007. Rezulton e provuar se prona e mësipërme është transkriptuar në regjistrin hipotekor nr.xxxx. Konkretisht në regjistrin hipotekor nr.195, datë 18.07.2007, rezulton se prona e mësipërme është regjistruar në emër të pandehurit X, në bazë të dëshmisë së trashëgimisë ligjore të lëshuar me vendimin nr.xxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Rezulton e provuar se kjo pasuri është ndarë në dy pasuri mbi bazën e kërkesës së të pandehurit X, duke u transkriptuar në regjistrin hipotekor nr.xxxxx. Në regjistrin hipotekor me nr.xxxxxx, rezulton se është pasqyruar fakti i ndarjes së pasurisë së mësipërme, e konkretisht në këtë regjistrër hipotekor është regjistruar pasuria "xxxx, një sipërfaqe toke kullotë prej 33.000 metër katrorë, e cila është regjistruar në emër të pandehurit X. Kjo sipërfaqe prone i është shitur shtetasit xxxxx sipas kontratës noteriale nr.xxxxxx kol, datë

xxxx. Kontrata e mësipërme është regjistruar në regjistrin hipotekor nr.xxxxxx, sipas së cilit sipërfaqja prej 33.000 metër katrorë është regjistruar në emër të shtetasit xxxx.

Kjo sipërfaqe prone rezulton se është shitur në shumën prej 6.000.000 (gjashtë milion) Lekë dhe në kontratën noteriale është përcaktuar se shuma e parave është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në regjistrin hipotekor nrxxxxxxx, rezulton se është pasqyruar fakti i ndarjes së pasurisë së mësipërme, e konkretisht në këtë regjistrër hipotekor është regjistruar pasuria "xxxxx-Vlorë, një sipërfaqe toke kullotë prej 15.000 m2, e cila është regjistruar në emër të pandehurit X. Kjo sipërfaqe prone i është shitur shtetasit xxxxx sipas kontratës noteriale nr.xxxxxx. Kontrata e mësipërme është regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 360, datë 28.08.2012, sipas së cilit sipërfaqja prej 15.000 m2 është regjistruar në emër të shtetasit xxxxxi. Kjo sipërfaqe prone rezulton se është shitur në shumën prej 3.007.500 (tremilion e shtatë mijë e pesëqind) Lekë.

5. Nga administrimi i dosjes që i përket vendimit nr.xxxxx-së Qarku Vlorë, rezulton se si dokumente pronësie janë përdorur dokumentet e mëposhtme:

- Vendimi nr. xxxxxx i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përmes së cilit është vendosur: "1. Të pranohet kërkesën e X. 2. Të vertetoje faktin juridik se z. X (si trashëgimtar)-në xxxxx në vendin e quajtur "xxxxxxe" ti njohet e drejta e pronësisë mbi 4.8 ha tokë kullotë me kufi: V-Rruga, J-Deti, L-xxx, P-Musha Fshati. 3. Të rivendosë në afat për kërkimin e pronës kullotë në xxxx pranë K.K.K Pronave Qarku Vlorë".

Vendim nr. xxx i Këshilit të Bashkisë Himarë, përmes së cilit është vendosur të njihet X si pronarë i një kullote prej një sipërfaqe 4.8 (katër presje një) ha, në vendin xxxx. Rezulton se ky vendim është nënshkruar nga sekretari xxxxx si dhe nga shtetasi xxxxx në cilësinë e kryetarit.

Procesverbal i mbajtur nga pleqësia e fshatit Vuno më datë 21.11.2002, sipas së cilit rezulton se shtetasi xx është njohur pronar i një kullote në vendin Ngalë.

Vertetim i komisionit të verifikimit të pronave pranë Bashkisë Himarë datë 10.12.2002, përmes së cilit është njohur si pronarë shtetasi X për një sipërfaqe kullote prej 4.8 ha. Ky dokument është nënshkruar nga shtetasit xxxxx dhe xxxx.

Vertetim datë 21.11.2002 i lëshuar nga kryeplaku i fshatit xx, përmes së cilit vertetohet se shtetasi X ka pasur në pronësi para reformës agrare 4.8 (katër pike tetë) ha tokë kullotë në vendin e quajtur xxxxx.

Rezulton se të gjitha dokumentet e mësipërme kanë dalë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, të cilat kanë qenë të administruara më parë në dosjen gjyqësore civile, që i përket vendimit nr. xxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Referuar shënimit të pasqyruar në këto dokumente nga arkivistja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se këto dokumente janë shërbyer më datë

24.05.2004. Ndërsa nga administrimi i dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr.xxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se janë përdorur këto dokumente:

Kërkesë drejtuar Kryepleqësisë së x, e cila është nënshkruar (firmosur) nga shtetasi X. Vertetim xxxxx i lëshuar nga kryeplaku i fshatit xxxxo, përmes së cilit vertetohet se shtetasi X ka pasur në pronësi para reformës agrare 4.8 (katër pike tetë) ha tokë kullotë në vendin e quajtur xxxx.

Vertetim i komisionit të verifikimit të pronave pranë xxxx datë 10.12.2002, përmes së cilit është njohur si pronarë shtetasi X për një sipërfaqe kullote prej 4.8 ha. Ky dokument është nënshkruar nga shtetasit xxxxx. Në lidhje me këtë dokument shtetasi xxxx ka pranuar nënshkrimin e tij, ndërsa shtetasi xxx ka deklaruar se mendon se nënshkrimi është i tij.

Procesverbal i mbajtur nga pleqësia e fshatit xxxxx më datë 21.11.2002, sipas së cilit rezulton se shtetasi xxxxxxx është njohur pronar i një kullote në vendin Ngalë. Ky dokument është nënshkruar nga shtetasit xxxxxi. Në lidhje me këtë dokument shtetasi xxxxx ka mohuar shkrimin dhe nënshkrimin, ndërsa shtetasit xxxxx kanë pranuar nënshkrimin e këtij dokumenti.

Vendim nr. xxxxx i Këshillit të Bashkisë Himarë, përmes së cilit është vendosur të njihet X si pronarë i një kullote prej një sipërfaqe 4.8 (katër presje një) ha, në vendin xxxx. Rezulton se ky vendim është nënshkruar nga sekretari xxxx si dhe nga shtetasi Jorgji Buta në emër të kryetarit Petro Jovani. Në lidhje me këtë dokument shtetasi xxxx ka pranuar nënshkrimin e tij.

5.1 Në funksion të hetimit është vendosur kryerja e ekspertimit tekniko-grafik të dokumenteve të mësipërme, të cilat janë përdorur në procesin gjyqësor të konkretizuar me vendimin nr.xxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Bazuar në aktin e ekspertimit tekniko-grafik nr. xxxx, ka rezultuar se: Dorëshkrimet plotësuese që ndodhen tek dokumentet “Kërkesë”, drejtuar Kryepleqësisë së fshatit Vuno; “Vërtetim”, datë xxxx “Vërtetim”, datë xxxx i komisionit të verifikimit të pronësisë pranë Komunës Himarë; “Proces Verbal”, datë xxx i K.xxxxx xxx, të numërtuar me nr. xxxx në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. xxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; “Vendim” nr. xxxxx, datë

xxx Për Njohje Pronësie, i Komunës Himarë (pa shkrimin Axxxxx) objekte ekspertimi, janë shkruar me mjet shkruar me tonalitete boje ngjyrë blu, të ngjashëm me njëri-tjetrin. Dorëshkrimet plotësuese që ndodhen tek dokumentet “Kërkesë”, drejtuar Kryepleqësisë së fshatit xxx; “Vërtetim”, datë xxxx i K.Pleqësisë së fshatit xxo; “Vërtetim”, datë xxxx i komisionit verifikimit të pronësisë pranë Komunës Himarë; “Proces Verbal”, datë 21.11.2002 i K.Pleqësisë së Fshatit Vxxxxx, të numërtuar me nr. Xxxx në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. xxxxx3 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; “Vendim” nr. xxx

Për Njohje Pronësie, i Komunës Himarë (pa shkrimin xxxx) objekte ekspertimi, janë shkruar nga i njëjti person. Dorëshkrimet plotësuese që ndodhen tek dokumentet “Kërkesë”, drejtuar Kryepleqësisë së fshatit xxxo; “Vërtetim”, datë xxxx i K.Pleqësisë së fshatit xxxxxhatit xxxx “Vendim” nr. xxxxx Për Njohje Pronësie, i Komunës Himarë (pa shkrimin xxxxxx) objekte ekspertimi, nuk përjashtohet mundësia të jenë shkruar nga shtetasi xxxxxx. Organi procedues ka sekuestruar në cilësinë e provës, vendimin nr. xxxxxx të Këshillit të Bashkisë Himarë që i përket subjektit X, si dhe është vendosur kryerja e ekspertimit tekniko-grafik. Ky dokument është sekuestruar në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr.592, datë 11.04.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Bazuar në aktin e ekspertimit tekniko-grafik nr.xxxxx.2015 rezulton se, shkrimi emër mbiemër “xxxxx” dhe nënshkrimi është shkruar dhe nënshkruar nga shtetasit Artan Llazari, krahasuar me modelet e paraqitura në emër të tij. Ndërsa shkrimi emër mbiemër “xxxxx” dhe nënshkrimi duhet të jetë shkruar dhe nënshkruar nga shtetasi xxxxx, krahasuar me modelet e paraqitura në emër të tij. Ndërsa vula e njomë e Bashkisë Himarë e ndodhur në këtë dokument është formuar nga e njëjta klishe që ka formuar vulat model krahasimi me të njëjtën përmbajtje. Nga deklarimet e shtetasit xxxx rezulton se ky shtetas ka pranuar faktin e nënshkrimit të dokumentit të mësipërm. **Nga këqyrja e librit të protokollit të mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Himarë, i cili është sekuestruar me procesverbalin e datës 18.09.2015, rezulton se nga Këshilli i Bashkisë Himarë, nuk është pasqyruar ndonjë vendim për njohjen e pronësisë në favor të shtetasit xxxxx apo X.** Bazuar në procesverbalin e mbledhjes së zhvilluar më datë 31.01.2003 nga Këshilli i Bashkisë Himarë, rezulton se është pasqyruar miratimi i kalimit në pronësi të kullotave vetëm për shtetasit xxxxx. Kështu, nga ana e organit të akuzës pretendohet se duke qenë se dokumenti Vendim nr. xxxx i Këshillit të Bashkisë xxxx nuk është paqyruar në librin e mbledhjeve të Bashkisë xxx,n uk është marrë në mbledhjen e datës 31.01.2003 dhe për rrjedhojë është i falsifikuar.

6. Në gjykimin e procedimit penal nr.xxxx në ngarkim të të pandehurit X duke qenë se u zhvillua me ritin e gjykimin të zakonshëm u dëgjuan me cilësinë e dëshmitarit shtetasit: xxxx (*Kryeplak i fshatit Vuno*) i cili i pyetur në cilësinë e dëshmitarit deklaroi se: Ka qenë kryeplak i fshatit xxxx në vitet 1998-2003 dhe shpjegoi para gjykatës procedurën që ndiqej në rastin e verifikimit të pronave për të cilat paraqisnin kërkesë fshatarët. Ai shpjegoi para gjykatës se, e mbante mend verifikimin që ishte kryer në rastin e shtetasit X pasi ky i fundit kishte pretendime në lidhje me një pronë ku kulloste bagëtitë në dimër. Dëshmitari tregoi para gjykatës anëtarët e komisionit që kanë marrë pjesë në verifikimin e rastit të X si dhe dëshmitarët që ishin pyetur (*se mbante mend*). Ai shpjegoi se në përfundim hartohet një dokument i cili quhej “njohje pronësie e...” dhe bashkë me deklaratat e kufitarëve i dërgohej Këshillit të Bashkisë xxxx. Ai ka shpjeguar se në disa raste merre pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Himarë dhe në disa raste jo, dhe në lidhje me rastin e X nuk i kujtohej nëse kishte marrë pjesë. I pyetur në cilësinë e dëshmitarit shtetasi xxxxi deklaroi se ka qenë anëtar i Kryepleqësisë së fshatit xxxx në vitet 1998-2004. I pyetur rreth çështjes së të pandehurit X ai shpjegoi se nuk mbante mend nëse ishte trajtuar rasti i të pandehurit X pasi kishte kaluar kohë e gjatë, por ai pranoi se dokumentin për njohje pronësie e kishte nënshkruar. xxxx (*i punësuar në vitet 2000-2003 pranë xxxx*) në dëshminë e tij shpjegoi se, ka qenë anëtar i Komisionit për verifikim e pretendimeve të pronësisë. Në lidhje me rastin e xxxx ai ka deklaruar se, ka marrë pjesë sëbashku me xxxx në relativimin para Këshillit Bashkiak Himarë dhe kujton se vendimmarrja ka qenë pozitive (*është aprovuar*). Në pamundësi për t’u dëgjuar dëshmitari xxx u procedua me leximet e lejueshme për të, bazuar në nenin 369 të K.Pr.Penale. Kështu, shtetasi xxx i pyetur gjatë hetimeve paraprake ka deklaruar seka qenë nën/kryetar i Këshillit Bashkiak Himarë për periudhën 2000-2003 dhe në vendimin nr.xxxxx emri, mbiemri dhe firma është e tij.

Nga shqyrtimi i akteve shkresore si dhe nga deklarimet e dëshmitareve te pyetur nen betim ne seance gjyqësore u provua se i pandehuri X njihet ne zone dhe si xxxx.

7. Faktet e cituara më lart provohen nga këto prova:

Kallëzimi penal i paraqitur nga Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë, përmes shkresës nr. xxxx, bashkë me Rekomandimet e Task-Forcë për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të paluajtshme shtetërore;

Procesverbali për sekuestrimin e dokumentit, datë xxxx, bashkë me dokumentin e sekuestruar e konkretisht e konkretisht të gjitha aktet që i përkasin dosjes gjyqësore civile me nr. xxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;

Procesverbali për sekuestrimin e dokumenteve, datë xxx e bashkë me dokumentet e sekuestruara;

Procesverbali për sekuestrimin e dokumenteve, datë xxxx, bashkë me dokumentin e sekuestruar, e konkretisht vendimi nr.

xxx Për njohje pronësie i Këshillit të Bashkisë xxxx

Procesverbali për sekuestrimin e dokumenteve, datë xxxx, pranë Bashkisë xxx, bashkë me dokumentet e sekuestruara;

Procesverbali për sekuestrimin e dokumenteve, datë 02.02.2015, pranë ZVRPP Vlorë, e konkretisht të gjitha praktikat e regjistrimit të pasurive mbi bazën e vendimit nr. xxxx, KVKKP-së Qarku Vlorë, si dhe praktikat në lidhje me ndarjet dhe tjetërsimin e këtyre pranave, të cilat i përkasin shtetasit xxxx.

Akti i ekspertimit tekniko-grafik nr. xxxx, bashkë me tabelën fotografike; Akti i ekspertimit tekniko-grafik nr. xxxxx, bashkë me tabelën fotografike;

Të dhënat e administruara pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë, përmes shkresës nr. xxxxx1 prot, datë 30.01.2015, e konkretisht dosja që i përket vendimit nr. xxxx të KVKKP-së Qarku Vlorë.

Procesverbali për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve datë 11.02.2015, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bashkë me dokumentet e administruara;

Të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, përmes shkresës nr. xxxx;

Të dhënat e administruara pranë Zyrës së Gjendjes Civile Bashkia Himarë përmes shkresës nr. xxxx; Të dhënat e administruara pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave Tiranë, përmes shkresës nr. xxxx; Dokumenti vertetim, datë 10.01.2018, lëshuar nga Kryesia e Fshatit xxxx, i cili është paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit më

datë 12xxxx;

Vendimi nr. xxxx i Gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe vendimi datë 01.06.2010 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për pushimin e procedimit penal nr. 216 të vitit 2010;

Procesverbali për marrjen e të dhënave nga nga personi që ka dijeni për veprën penale, e konkretisht të shtetasit xxxx

Procesverbali për marrjen e të dhënave nga nga personi që ka dijeni për veprën penale, e konkretisht të shtetasit xxx, datë 31.01.2018.

Procesverbali për marrjen e të dhënave nga nga personi që ka dijeni për veprën penale, e konkretisht të shtetasit xxx, datë 22.01.2018.

Procesverbali për marrjen e të dhënave nga nga personi që ka dijeni për veprën penale, e konkretisht të shtetasit xxxxxi, datë 19.01.2018.

Procesverbali për marrjen e të dhënave nga nga personi që ka dijeni për veprën penale, e konkretisht të shtetasit xxxx, datë 16.01.2018.

Procesverbali për marrjen e të dhënave nga nga personi që ka dijeni për veprën penale, e konkretisht të xxxxx, datë 12.01.2018.

Procesverbali për marrjen e të dhënave nga nga personi që ka dijeni për veprën penale, e konkretisht të shtetasit xxxx, datë 12.01.2018.

Procesverbali për marrjen e të dhënave nga nga personi që ka dijeni për veprën penale, e konkretisht të shtetasit xxxx, datë 12.01.2018.

Akte të tjera të këtij fashikulli të procedimit penal.

III. Ligji i zbatueshëm:

Ø Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Neni 186 i Kodit Penal: *"Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet".*

Neni 287 i Kodit Penal: *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet: a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale; ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjisllacionit për parandalimin e pastrimit të parave; d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale; 181 dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër; - dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur kjo veprë kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. E njëjta veprë, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim ...".*

Ø Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.

Neni 388/a i K.Pr.Penale parashikon: *"a) fakti nuk ekziston ose nuk provohet se ekziston".*

IV. Vlerësimi i gjykatës:

A. Në lidhje me akuzën për kryerjen e veprës penale "Falsifikim i dokumentave" në formën e përdorimit parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal:

8. Përgjegjësia penale është detyrimi ligjor i çdokujt, që shkel një rregullim normativ me karakter penal, për t'iu nënshtruar pasojave ligjore me karakter ndëshkues e parandalues. Nisur nga rëndësia që kanë organet proceduese penale përgjatë të gjithë veprimtarisë që përbën në tërësi procedimin penal, nga intensiteti i madh i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të nënshtruara dhe nga nevoja për zhvillimin e një procedimi të ndershëm, të rregullt dhe tërësisht në përputhje me ligjin, Kodi Penal ka parashikuar disa kushte kumulative që duhet të përmbushen në çdo procedim penal. Gjykata, paraparakisht evidenton faktin se për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementët e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston. Prandaj, në çështjen konkrete, gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Figura e veprës penale, pasqyron formën juridike të veprës penale për rastin konkret. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi, nuk mund të dënohet. Prandaj, më poshtë, Gjykata çmon të analizojë elementët e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri X

9. Duke u rikthyer në çështjen objekt gjykimi, prokuroria e akuzon të pandehurin X, për veprën penale të "Falsifikimi i dokumenteve", në formën e përdorimit të një dokumenti të falsifikuar. Prandaj, në çështjen objekt gjykimi, gjykata, duhet të analizojë elementët e figurës së veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, i ndryshuar. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: **"Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet.**

Kur falsifikim bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet". Ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht se figura e veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve" nga ana objektive kryhet në dy forma: nëpërmjet "falsifikimit të dokumenteve" dhe nëpërmjet "përdorimit të dokumenteve të falsifikuara" nga vetë personi që e ka kryer falsifikimin apo nga një person tjetër që ka interes për përdorimin e tij. Gjykata vlerëson se, që të arrihet në konkluzionin se jemi përpara kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal në formën e përdorimit, do të duhet të provohen nga organi i akuzës përtej çdo

dyshimi të arsyeshëm këto kushte kumulative: i) Dokumenti është i falsifikuar; ii) Përdorimi i aktit të falsifikuar; iii) Të vërtetohet dijenia e subjektit të veprës penale së akti i përdorur prej tij përmban të dhëna të rreme, sikundër të jetë evident dhe qëllimi i fitimit apo çdo lloj interesi tjetër personal nga përdorimi i këtij dokumentacioni të falsifikuar. Në analizë të kushteve të mësipërme, gjykata duhet të marrë në shqyrtim para së gjithash nëse provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se vendimi i Këshillit Bashkiak Himarë (dokumenti) nrxxx është i falsifikuar në kuptimin që përmban të dhëna të rreme. **Nga ana e organit të akuzës pretendohet se dokumenti vendim nr.xxxx i Këshillit Bashkiak Hxxx është i falsifikuar duke qenë se nuk është pasqyruar në librin e mbledhje të Këshillit Bashkiak Himarë.** Gjikata vlerëson se, vetëm fakti që vendimi i Këshillit Bashkiak Himarë nr.xxxx nuk është pasqyruar në librin e mbledhje nuk të shpie në konkluzionin se vendimi i Këshillit Bashkiak xxxx nuk është marrë dhe përmban të dhëna të rreme. Ndërkaq nga thëniet e dëshmitarëve rezultoi se trajtimi me tokë i shtetasit X është marrë në shqyrtim nga Këshilli Bashkiak dhe është marrë vendim pozitiv. Konkretisht, gjatë gjykimit të zhvilluar me ritin e gjykimit të zakonshëm, shtetasi xxxxx) i pyetur në cilësinë e dëshmitarit deklaroi se: *Ka qenë kryeplak i fshatit xxxo në vitet 1998-*

*2003 dhe shpjegoj para gjykatës procedurën që ndiqej në rastin e verifikimit të pronave për të cilat paraqisnin kërkesë fshatarët. Ai shpjegoj para gjykatës se, e mbante mend verifikimin që ishte kryer në rastin e shtetasit X pasi ky i fundit kishte pretendime në lidhje me një pronë ku kulloste bagëtitë në dimër. Dëshmitari tregoj para gjykatës anëtarët e komisionit që kanë marrë pjesë në verifikimin e rastit të X si dhe nga dëshmitarët që ishin pyetur (se mbante mend). Ai shpjegoj se në përfundim hartohej një dokument i cili quhej "njohje pronësie e..." dhe bashkë me deklaratat e kufitarëve i dërgohej Këshillit të Bashkisë xxx. Ai ka shpjeguar se në disa raste merrte pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Himarë dhe në disa raste jo, dhe në lidhje me rastin e X nuk i kujtohej nëse kishte marrë pjesë. I pyetur në cilësinë e dëshmitarit shtetasi Sotir Andoni deklaroi se ka qenë anëtar i Kryepleqësisë së fshatit Vuno në vitet 1998-2004. I pyetur rreth çështjes së të pandehurit X ai shpjegoi se nuk mbante mend nëse ishte trajtuar rasti i të pandehurit X pasi kishte kaluar kohë e gjatë, por ai pranoj se dokumentin për njohje pronësie e kishte nënshkruar. xxxx (i punësuar në vitet 2000-2003 pranë xx) në dëshminë e tij shpjegoi se, ka qenë anëtar i Komisionit për verifikim e pretendimeve të pronësisë. **Në lidhje me rastin e xxx ai ka deklaruar se, ka marrë pjesë sëbashku me xxxx në relativimin para Këshillit xxx dhe kujton se vendimarrja ka qenë pozitive (është aprovuar).** Në pamundësi për t'u dëgjuar dëshmitari Jorgji Buta u procedua me leximet e lejueshme për të, bazuar në nenin 369 të K.Pr.Penale. Kështu, shtetasi Jorgji Buta i pyetur gjatë hetimeve paraprake ka deklaruar seka qenë nën/kryetar i Këshillit Bashkiak Himarë për periudhën 2000-*

*2003 dhe në vendimin nr.xxxx emri, mbiemri dhe firma është e tij. **Sa më sipër, gjykata vlerëson se, nga thëniet e dëshmitarëve nën betim rezulton se, i pandehuri X ka ndjekur procedurën ligjore dhe kërkesa e tij është trajtuar e aprovuar në Këshillin Bashkiak Himarë.*** Gjikata çmon se, parregullsitë administrative në lidhje me paqyrimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak Himarë në librin e mbledhjeve nuk mund t'i kundërvihen qytetarëve dhe të shpien në përgjegjësinë penale të tij. Gjikata e gjen me vend të theksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t'i krijojë gjykatës bindjen "**përtej çdo dyshimi të arsyeshëm**" se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Sipas Vendimit Unifikues Nr. 7 të datës 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: "*Për vendimin përfundimtar lidhur me themelin e akuzës, gjykata disponon bazuar në bindjen e saj mbështetur në prova që vërtetojnë ose jo akuzën, pra jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Asnjë provë nuk mund të ketë një vlerë të paracaktuar, si në drejtim të fajësisë ashtu edhe të pafajësisë.*".Pra, në procesin penal, organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo element që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri. Nga ana e tij, i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të provojë pafajësinë e tij, megjithatë, ai gëzon të drejtën të mbrohet në procesin penal, në përputhje me procesin e rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Lidhur me standardin e vlerësimit të provave GJEDNJ, **në çështjen Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë** shprehet se: "*Për të vlerësuar provat e faktit, Gjikata adopton standardin e të provuarit "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm", por shton se prova të tilla duhet të ndiqen nga bashkëekzistenca e deduktiveve përkuese, mjaftueshmërisht të fortë dhe të qartë ose nga prezumime të njëjta e të pakundërshtueshme të faktit.*"

9.1 Gjithashtu, Gjikata për të përcaktuar faktin penal, është e detyruar të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: "*1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.*". Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjikata Kushtetuese në vendimin Nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: "*Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilin është **in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit**dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjikata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza.*".Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit ("akuzës", "veprës penale" për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt,) ky duhet bërë në favor të të pandehurit. Në bazë të këtij parimi pranohet se **kur gjykata e shpall të pandehurin të pafajshëm, ajo nuk duhet të bindet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. I pandehuri shpallet i pafajshëm atëherë kur organi i akuzës nuk ka arritur të provojë në gjykatë se i pandehuri e ka konsumuar veprën penale në të gjithë elementët e saj përbërës ose kur ekziston një dyshim për akuzën, i cili sipas parimit të njohur *in dubio pro reo*, çmohet nga gjykata në favor të të pandehurit. Në vijim të sa më sipër, gjykata vlerëson se, **organi i akuzës nuk provoi përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se dokumenti i përdorur nga i pandehuri X është i falsifikuar** duke mos u përmbushur kështu një nga kushtet për lindjen e përgjegjësisë penale në kuptim të nenit 186 të Kodit Penal. **Sa më sipër u arsyetua, gjykata vlerëson se i pandehuri duhet të deklarohet i pafajshëm lidhur me veprën penale "Falsifikim i dokumentave" parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal në përputhje me nenin 388/a të K.Pr.Penale.****

B. Në lidhje me akuzën për kryerjen e veprës penale "Pastrim i produkteve të veprës penale" parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal:

10. Gjikata vlerëson se, duke qenë se nuk u provua gjatë gjykimit se dokumenti vendimi i Këshillit Bashkiak të Himarës nrxxxxx është i falsifikuar dhe për këtë akuzë i pandehuri u deklarua i pafajshëm edhe për veprën penale "*Pastrim i produkteve të veprës penale*" parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal duhet të deklarohet i pafajshëm. Në kushtet kur nuk u provua se vendimi i Këshillit Bashkiak Himarë nuk është i falsifikuar për rrjedhojë edhe pasuria nuk është produkt i një vepre penale dhe i pandehuri X duhet të deklarohet i pafajshëm edhe lidhur me veprën penale "*Pastrim i produkteve të veprës penale*" parashikuar nga neni 287/3 i Kodit Penal.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet 379, 384, 388/a të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 186/2 e 287/3 të Kodit Penal;

VENDOSI:

1. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit X lidhur me kryerjen e veprave penale "*Falsifikimi i dokumenteve*", të kryer më shumë se një herë, përmes përdorimit të dokumentit të falsifikuar dhe "*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", parashikuar nga nenet 186/2 dhe 287/1 germa "a" dhe "b" të Kodit Penal.
2. Heqjen e masës së sekuestros preventive vendosur me vendimin gjyqësor nr.xxxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
3. Shpenzimet e hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore siç janë kryer.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga e nesërmja e shpalljes së tij.

U shpall sot në Vlorë, me datë 25.09.2018!

GJYQTAR
ERVIN TRASHI

VJOLA CANAJ

GJYQTARE **GJYQTAR**
SKËNDER HALUCI
SEKRETARE
EGLANTINA MURATI

SHPENZIMET GJYQËSORE

Shpenzime gjate hetimeve paraprake	100.000	Lekë
Shpenzime kancelarie	3.000	Lekë
Shpenzime totale	103.000	Lekë

SEKRETARE
EGLANTINA MURATI

Për këto arsye

X Y

VENDOSI:

X Y

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

GJYQTAR:

Skender Haluci